



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2209/4 prot

Datë 04.11.2022

V E N D I M
Nr. 1066 /2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.11.2022 me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-38481-08-15-2022 me objekt “Blerje hipoklorit natriumi për kërkesat e Ndërmarrjes”, me fond limit 3,600,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.09.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Sarandë sh.a.

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime Sarandë sh.a
Adresa: Gjashtë, Sarandë

Ankimues: Operatori ekonomik “2 AT” SHPK
Adresa: Rruga Korçë – Dishnicë, Km 1, Korçë

Baza Ligjore: Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.08.2022, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-38481-08-15-2022 me objekt “Blerje hipoklorit natriumi për kërkesat e Ndërmarrjes”, me fond limit 3,600,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.09.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Sarandë sh.a.

II.2. Në datën 10.10.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nga ku rezulton për vlerat pa TVSH si më poshtë:

1.	“2 AT” SHPK	3.550.000 lekë	skualifikuar
2.	“Atlantik 3” SHPK	00.00	skualifikuar

II.3. Në datë 11.10.2022 autoriteti kontraktor ka kryer publikimin e Njoftimit të Anulimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si edhe në buletin nr. 143, datë 17.10.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik

II.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 11.10.2022 është protokolluar ankesa me nr. 2209 prot., e operatorit ekonomik “2 AT” SHPK paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëkohësisht paraqitur pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2209/2 prot., datë 12.10.2022, janë publikuar arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik “2 AT” SHPK ngre pretendime.

II.6. Me shkresën nr. 339/1 prot, datë 28.10.2022 protokolluar me tonën me nr. 2209/3 prot datë 01.11.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor me vendimin e datës 27.10.2022 ka pranuar plotësisht ankesën, si më poshtë vijon:

“[...]... Për sa më sipër; Komisioni i Shqyrtimit dhe i Vlerësimit të Ankesave, konkludon se;

Në zbatim të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 36 pika 2, 5, 6 për “Specifikimet Teknike”, neni 77 pika 1, 4 për “Kërkesat për Kualifikim”, neni 79 pika 1 për “Standartet e Cilësisë”, neni 80 pika 1 për “Parimet e procesit të përzgjedhjes” dhe neni 87 për “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”,

Operatori Ekonomik “2 AT”shpk, në vlerësimin përfundimtar është s’kualifikuar pa të drejtë pasi Operatori Ekonomik plotëson kërkesat e pikës 2.3.3 modifikuar me shtojcën 1 të kërkuara sipas DST-së.

Në këto kushte, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se, Vendimi i KVO i ngritur nga AK në lidhje me tenderin, me objekt prokurimi “Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Ndërmarrjes”, për s’kualifikimin e OE “2 AT” shpk për mos plotësim të Kritereve Teknike pika 2.3.3 modifikuar me shtojcë 1 është i padrejtë dhe jo i bazuar në ligj.

Gjithashtu, Komisioni konkludon se; Nuk mund të vlerësoj mjaftueshmërinë e grupit të indikatorëve të analizuar për produktin Hipoklorit Natriumi objekt prokurimi.

Në përfundim, Komisioni:

VENDOSI

- 1. Rëzimin e vendimit të KVO datë 05.10.2022, të ngritur për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Ndërmarrjes”, me përcaktim se; Operatori Ekonomik “2 AT”, S’kualifikohet***
- 2. Shpalljen e operatorit ekonomik “2 AT” shpk në këtë procedurë prokurimi, të KUALIFIKUAR***
- 3. Vendimi i mësipërm i paraqitet titullarit të Autoritetit Kontraktor.[...]”***

III
Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëlidhur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet operatorit ekonomik “2 AT” SHPK mbi kundërshtimin vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Me shkresën nr. 339/1 prot, datë 28.10.2022 protokolluar me tonën me nr. 2209/3 prot datë 01.11.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor me vendimin e datës 27.10.2022 ka pranuar plotësisht ankesën, si më poshtë vijon:

*“[...]... **Për sa më sipër; Komisioni i Shqyrtimit dhe i Vlerësimit të Ankesave, konkludon se;***

Në zbatim të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 36 pika 2, 5, 6 për “Specifikimet Teknike”, neni 77 pika 1, 4 për “Kërkesat për Kualifikim”, neni 79 pika 1 për “Standartet e Cilësisë”, neni 80 pika 1 për “Parimet e procesit të përzgjedhjes” dhe neni 87 për “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”,

Operatori Ekonomik “2 AT”shpk, në vlerësimin përfundimtar është s’kualifikuar pa të drejtë pasi Operatori Ekonomik plotëson kërkesat e pikës 2.3.3 modifikuar me shtojcën 1 të kërkuara sipas DST-së.

*Në këto kushte, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se, Vendimi i KVO i ngritur nga AK në lidhje me tenderin, me objekt prokurimi “**Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Ndërmarrjes**”, për s’kualifikimin e OE “2 AT” shpk për mos plotësim të Kriterëve Teknike pika 2.3.3 modifikuar me shtojcë **1 është i padrejtë dhe jo i bazuar në ligj.***

*Gjithashtu, Komisioni konkludon se; **Nuk mund të vlerësoj mjaftueshmërinë e grupit të indikatorëve të analizuar për produktin Hipoklorit Natriumi objekt prokurimi.***

Në përfundim, Komisioni:

VENDOSI

- 1. Rëzimin e vendimit të KVO datë 05.10.2022, të ngritur për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Ndërmarrjes”, me përcaktim se; Operatori Ekonomik “2 AT”, S’kualifikohet***
- 2. Shpalljen e operatorit ekonomik “2 AT” shpk në këtë procedurë prokurimi, të KUALIFIKUAR***
- 3. Vendimi i mësipërm i paraqitet titullarit të Autoritetit Kontraktor.[...]”***

II.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njezëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga “2 AT” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-38481-08-15-2022 me objekt “*Blerje hipoklorit natriumi për kërkesat e Ndërmarrjes*”, me fond limit 3,600,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.09.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Sarandë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga “2 AT” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Nënkryetar

Fiorent Zguro